



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:122177

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07017504

Numri i lëndës: 2019:122177

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07017504

Ac.nr.8429/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Halide Reka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. G. nga F., me autorizim e përfaqëson B. R. avokat nga Ferizaj, kundër të paditurit B. G. nga fsh. M., Komuna Ferizaj, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.509/19 të datës 31.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurit B. G. nga fsh. M., Komuna Fe., ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.509/19 i datës 31.08.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.509/19 të datës 31.08.2022 ka vendosur në këtë mënyrë: **I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Sh. G. nga Ferizaj, si e bazuar. **II. DETYROHET** i padituri B. G., që paditësit për dëmin shkaktuar me rastin e prerjes së pyllit në mënyrë ilegale, të ia paguaj shumën prej 4,536.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e dorëzimit të padisë, si dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 1044.80 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

Kundër Aktgjykimit brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar i padituri për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që kjo gjykatë ta ndryshoj Aktgjykimin e atakuar duke refuzuar

kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, apo të njejtin ta prishë duke kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 11.12.2018, të precizuar në seancën kryesore të datës 10.08.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurit për kompensimin e dëmit.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat, ndërsa pas vlerësimit të tyre ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se lidhur me bazën juridike të padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit, gjykata me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1100/16, i datës 12.04.2018 dhe aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.623/18, i datës 31.07.2018, ka vërtetuar faktin se i njëjti është shpallur përgjegjës lidhur me veprën penale vjedhje pylli. Me aktvendimin e Zyrës Kadastrale në Ferizaj, me nr.20220-2021, vërtetohet fakti se paditësi sipas aktvendimit mbi trashëgimin me shenjën LRP.nr.4074/2021, të nxjerrë pranë zyrës noteriale në Ferizaj, është bërë pronar i parcelës nr.1040-0 ZK Mirashë. Me ekspertizën gjeodezike të gjeodetit Agim Hajredini, e hartuar me shkrim e dt.01.10.2019, i njëjti ka konstatuar se nga parcela nr.1040-0, ZK. Mirashë, e cila ka sipërfaqe 1027m², me kulturë mal, me një lartësi prej 2-3 metra dhe se prona e njejt është ka qenë në emër të F.G., tani është në emër të paditësit. Eksperti i vlerësimit Agron Qerkini, në ekspertizën e tij me shkrim të dt.28.03.2022, ka dhënë mendimin e tij profesional, sipas së cilit ka vlerësuar se sipërfaqja e parcelës P-1040-0 prej 1,027m², me kulturë tokë Pyjore-Mal, i klasit të 4-të, me drunje të llojit bung/qarr në pjesën dominate filiza në gjatësi të ndryshme kryesisht 2-5m, të mbirë nga trungjet e prerë më parë. Në llogaritjen e dëmit pyjore gjatë hartimit të ekspertizës është marrë për bazë oferta aktuale të shitjes së drunjëve për djegie në treg, vlera e shitjes së 1m³ dru bung/qarr varion në mesatare nga 40/50 euro për m³, por pa përjashtuar vlera më të larta apo më ulëta. Në ekspertizë është bërë përllotatija e dëmit sipas qmimorës nga MBPZHR-ës dhe sipas vlerës së tregut. Sipas qmimorës së MBPZHR-ës, për produktet pyjore nr. 2336-11 e datës 17.10.2012 nga Minsitria e Bujqësis dhe Zhvillimi Rural, shuma totale për kompensimin e dëmit pyjor për sasinë e masës drunore në 36 m³ sipas kësaj çmimore është 4.539.34 €, ndërsa sipas llogaritjes së dëmit për të njëjtën masë, në bazë të vlerës së tregut, kompensimi i dëmit pyjorë është 1,620 €. Me nenin 136 par.1 të LMD-së parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, ndërsa me dispozitën e nenit 140 të po këtij ligji parashihet se “fajësia ekziston

kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”. Sa i përket ekspertizës gjeodezike gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, ku parcela me numër 01040-0 ZK Mirash, në vendin e quajtur “Mbi rrugë” me sipërfaqe 1027, me kulturë tokë, Pyjore-Mal i klasës 4-tët, e cila pronë fillimisht ka qenë në pronësi në emër të F. G. pastaj me Aktvendimit nr. 20220-2021, ka kaluar në emër të paditësit Sh. G., me 1/1 e pjesës ideale është në sipas. Sa i përket vlerësimit të ekspertit vlerësues lidhur me prerjen e drunjtëve, gjykata të njejtës ia fali besimin lidhur me për llogaritjen e dëmit sipas çmimore për produktet pyjore nr. 2336-11, e datës 17.10.2013, e lëshuar nga Ministria e Bujqësis dhe pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Provave të lartë cekura gjykata u’a fali besimin dhe i pranoi si të sakta dhe profesionale por se me rastin e përcaktimit të lartësisë së dëmit mori për bazë vlerësimin e ekspertit të llogaritur sipas çmimore së MBZHR, marrë për bazë faktin se prerje e pyllit është bërë në kundërshtim edhe me rregullat e prerjes së pyllit siç parashihet me ligjin mbi pyjet e Kosovës neni 11 dhe 12.1 e 3 i këtij ligji, ku të paditësit i është shkaktuar dëmi me prerjen e drunjtëve në vëllimin prej 36m³, për çka edhe me ligjin mbi marrëdhënjet e detyrimeve parashihet se kush i shkakton dëm tjetrit ka për obligim kompensimin e atij dëmi apo rikthimin në gjendjen e mëparshme, e që në rastin konkret ky dëm është përcaktuar me shumë moneta e cila duhet ti kompensohet paditësit nga i padituri. Andaj për këto arsye e paditura është përgjegjëse për të kompensuar këtë dëm, në lartësinë e përcaktuar nga eksperti dhe të precizuar nga pala paditëse. Ndërsa pjesës të vlerësimit në treg gjykata nuk i’a ka falur besimin dhe nuk e morri për bazë pasi që qmimi në këtë rast të vlerësimit duhet të jetë çmim zyrtar në bazë të tarifave të MBPZHR-ës dhe duke pas parasysh se dëmi i shkaktuar është me vepër penale dhe se me të njëjtin dëm pos masës drunore është shkaktuar edhe pasoja në natyrë në kundërshtim me ligjin mbi pyjet e Kosovës. Pretendimet e të paditurës se prona ka kaluar gabimisht në emër të babait të paditësit nuk ka arritur të i bëjë të besueshme me asnjë fakt dhe me asnjë provë, gjithashtu edhe pretendimet se babai i paditësi ka marrë në kompensim pronë tjetër në vendin e quajtur “Te Lendina” këto pretendime nuk ka arritur ta vërtetoj me asnjë fakt apo provë që do ta bënin të bazuar një pretendim të tillë të paditurit. Sa i përket provave tjera të administruara në këtë procedurë, gjykata gjeti se të njëjtat nuk janë relevante për konstatimin e ekzistimit të dëmit dhe lartësisë së tij, andaj nuk e ka parë të nevojshme shtjellimin e tyre ndërsa sa i për ketë kontratës së dorëzuar nga e paditura si provë krahasues, gjykata ka gjetur se e njëjta nuk është marrë për bazë nga se prona objekt shitblerje nuk i ka asnjë nga karakteristikat e ngjashme me pronat objekt kontesti nga shpronësimi faktik nga e paditura. Lidhur me pagesën e kamatës gjykata, vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së. Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë, Gjykata konform neneve 2, 5 dhe 143 të LPK-së, si dhe neneve 136 par.1, 140, të LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Për shpenzimet e procedurës Gjykata ka vendosur konform nenit 452 par.1 të LPK-së, duke e detyruar të paditurin që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1044.80 € dhe atë si në vijim: për taksën gjyqësore për padi shumën prej 100.00 €, për përpilimn e ankesës shumën prej 104.00 €, për katër seanca të mbajtura shumën prej 540.80€, për ekspertizën gjeodezike shumën prej 100.00 €, për ekspertizën e vlerësimit shumën prej 200.00 €.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me

zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore e të paditurit për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadisë dhe shumën e aprovuar.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit. Ndërsa, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, Gjykata e Apelit i ka vërtetuar po ashtu edhe shumën e kompensimit, të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Si rrjedhojë e kësaj, është vendosur që aktgjykimit i atakuar të vërtetohet, e të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit.

Sipas kësaj gjykate përgjegjësia për shpërblimin e dëmit lind me rastin e shkakimit të dëmit. Vetë fakti i shkakimit të dëmit krijon detyrimin për shpërblimin e tij nga ana e shkakuesit të dëmit, ndërsa në rastin konkret i padituri me veprim ka shkaktuar dëmin paditësit, për shkak se me datë 06.10.2016 në pyllin privat në vendin e quajtur “Mbi Rrug” në parcelën 1040 ZK Mirash-Ferizaj, pronë e të paditurit ka prerë dru të njoma të llojit bung në sasi prej 200 metra kub, me të cilat veprime ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358.2 i KPRK-ës dhe për këtë vepër është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë (*Aktgjykimi P.nr.1100/1 i datës 12.04.2018, i formës së prerë nga data 31.07.2018*). Dëmi që shkaktohet me veprimin ose mosveprimin, krijon përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, respektivisht përgjegjësinë deliktore dhe nga këtu pala e dëmtuar fiton të drejtën që të kërkojë shpërblimin qoftë të dëmit material apo atij jomaterial. Përgjegjësia deliktore paraqitet si pasojë e shkeljes së parimit për të mos shkaktuar dëm. I dëmtuari (paditësi), me rastin e shkakimit të dëmit, është në pozitën e kreditorit, pasi për këtë lind e dreja që të kërkojë kompensimin e dëmit, kurse subjekti përgjegjës është në pozitën e debitorit, pasi ai duhet të bëjë zhdëmtimin.

Shkaktimi i dëmit është kushti me rëndësi për lindjen e detyrimeve për shpërblimin e tij. Ai është vendimtar për krijimin e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rezultojnë të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i

dëmit, si fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve. Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, është edhe lidhja kauzale që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Në rastin konkret kemi përgjegjësinë e të paditurit, vërteruar përmes aktgjykimit penal, ku përmes veprimeve të tij i është shaktuar dëm paditësit në shumën e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, lartësia e të cilit është vërtetuar përmes eksertizës së datës 28.03.2022 dhe sqarimit të saj në seancën kryesore të datës 28.06.2022.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë në lidhje me shumën e gjykuar për dëmin material për paditësit, duke vërtetuar lartësinë përmes ekspertizës së datës 28.06.2022.

Më tutje, kjo gjykatë e ka vërtetuar lartësinë e kamatës të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse e njejta është vendosur bazuar në nenin 382 të LMD-ës.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimi mbi shpenzimet procedurale, andaj refuzohen si të paqëndrueshme edhe pretendimet ankimore kundrejt tij. Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8429/2022, datë 18.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi